

PROCESVERBAL
nga seanca e 37-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 16.11.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr.Dragica Ljubevska, mr.Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski e hapi seancën e 37-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në orën 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 36-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 10.11.2023.
2. Propozim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (TVM3), për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM4), për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive SKAJ RADIO Teodor SHPKNJP - Shkup, për shkelje të neni 80 paragrafët (7), (8) dhe (9) të LSHMAAV.
6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të REPRO PRINT SHPKNJP nga Shkupi, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media.
7. Propozim-vendim për pagesën e dëmshpërblimit për vdekjen e familjarit .
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 36-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 10.11.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip. Ai sqaroi se të gjitha të dhënat janë të shënuara në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit programor, ku është konstatuar se transmetuesi ka mënjanuar pengesat ligjore për kryerjen e veprimtarisë. Për këtë arsye propozohet që të ndërpritet procedura e filluar për heqjen e lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, nr.08-64 datë 05.01.2015, vazhduar me Vendim, PA1 nr.08-258 datë 15.08.2023.

Në pajtim me Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit programor nr.10-4176/1 datë 10.11.2023, thuhet se më 19 tetor 2023, SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip ka transmetuar një shërbim të vetëm programor në tërësi të programeve dhe elementeve të tjera të një shërbimi të vetëm audio mediatik i destinuar për t'u marrë nga publiku nëpërmjet tre frekuencave të analizuar që përdor për të mbuluar zonën për të cilën i është dhënë leja, si dhe i ka mënjanuar pengesat e parashikuara me ligj për kryerjen e veprimtarisë, pra ka vepruar plotësisht sipas Njoftimit ark. nr.08-331 datë 09.10.2023.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pikat 3 dhe 4

Z. Petrushevski propozoi Pikat 3 dhe 4 të shpjegohen me një hyrje dhe diskutim ndërsa votimi të jetë individual për secilën prej tyre.

Këshilli e pranoi propozimin.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr.Emilija Janevska, shpjegoi propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike të NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i tretë programor (TVM3), për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media dhe të NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM4), për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se shkeljet janë konstatuar nga mbikëqyrja e rregullt e realizuar në tetor të këtij viti. Lidhur me shkeljen e TVM3, ajo ka shpjeguar se është shkelur detyrimi për publikim impresium për të cilën mediumi ka dërguar njoftim. Në shkresë shërbimi pretendon se gjatë transmetimit të ndeshjeve(lojrave) sportive ndërkombëtare në produksionin televiziv të TVM-së, kur TVM-ja është organizator i transmetimit nga i cili më pas sinjali shpërndahet me satelit dhe merret nga kanalet e huaja, siç janë ndeshjet e basketbollit nga Kupa e Evropës FIFA, ata thonë se në standardet ose " running orders " dmth listat e detyrueshme në formën e përmbledhjes me renditje oficiale nuk lejojnë transmetimin e shpicës çlajmëruese. Ata thonë se e njëjta situatë vlen edhe për transmetimin e ndeshjeve

sportive ndërkombëtare nga produksionet televizive të huaja, për këtë shembuj janë transmetimi i Ligës së Kampionëve të futbollit UEFA, ku në marrëveshjet për sigurimin e të drejtave televizive nuk është lejuar përdorimi i elementeve pronësore grafike jashtë pakos oficiale. Ata pohojnë se në çdo gjë tjetër, në të gjitha transmetimet që kanë qenë për ngjarje sportive vendase ku TVM e bën produksionin, e që me satelit nuk shpërndahen në stacione televizive të huaja, detyrimi ligjor është respektuar. Ditën kur është kryer mbikëqyrja, ka pasur ndeshje të panumërta nga të gjitha sportet, pas disa ritransmetimeve të disave, ka pasur ndeshje dhe nga këto dy kategori në të cilat pretendojnë se nuk lejohet të transmetojnë shpica çlajmëruese, megjithatë për këto ndeshje dhe nga Kupa e Evropës FIFA dhe nga Liga e kampionëve UEFA, në ato ndeshje nuk kishte asnjë informacion as se kush ishin komentuesit e ndeshjeve dhe as nuk u njoftua gojari. Ajo tha se për këto pjesë edhe njëherë do të duhet të bëhen bisedime me TVM dhe të kërkohen kontratat, të paraqiten ato pjesë të kontratave për tu parë se çfarë konkretisht është e ndaluar të transmetohet, mirëpo dhe nëse ndalohet grafikisht të publikohet ndoshta nuk ka ndalim në pjesën komentuese që udhëheqësi të prezantohet se kush është dhe të tregon ekipin realizues. Gjithashtu është konstatuar se shërbimi nuk ka as informacion se për cilën ndeshje bëhet fjalë, nëse bëhet fjalë për ritransmetim, që do të thotë se me TVM do të duhet të diskutohet për disa aspekte. Sido që të jetë, në ditën e analizës janë transmetuar edhe ndeshje nga ngjarjet sportive vendase në produksion të TVM ku nuk janë aplikuar të dhënat për impresium, si p.sh, ndeshja e ligës së futbollit të maqedonisë Shkupi me Strugën Trim Ljum me ritransmetim, dhe ndeshja e ligës së futbollit të maqedonisë të KF Maqedoni - Gjorçe Petrov me KF Brera nga Strumica. Kjo do të thotë se sigurisht që ka shkelje të nenit 14 të LM, pra atje ku thonë se për ndeshje të tilla aplikojnë impresium, nuk janë aplikuar. Megjithatë, për të ardhmen do të jetë e nevojshme të kontrollohet nëse kjo është e vërtetë për ndeshjet ndërkombëtare, nëse nuk është e mundur grafikisht, do të duhet të paktën publiku të marrë informacione për komentatorin, për ndeshjen nga cila datë është, sepse tani nuk ka informacion të tillë. Gjithashtu është konstatuar se ndeshje nga UEFA Ligë e kampionëve në ditën e analizës, transmetohen (shkojnë) në studio live, pra programi fillon në studio live. Më pas transmetohet (shkon) ndeshja dhe sërish përfundon me studio live. Në këto emisione në telop janë shënuar kush është prezantuesi dhe kush është i ftuari në studio dhe prezantuesi para se të fillon ndeshja ka bërë të ditur se cilët do të jenë komentatorët. Mirëpo, në përfundim të studios, në fund nuk kishte asnjë informacion për ekipin tjetër, kush ishte redaktori, kush ishte në regji, kush ishte udhëheqësi teknik, përveç se për atë ndeshje konkretisht qëndronte "produksioni TVM1". Këto ndeshje janë transmetuar në të tre kanalet paralelisht me faktin që në studion live të TVM2 në gjuhën shqipe shkon me të ftuar të tjerë. Ajo deklaroi se ka shkelje dhe për këtë arsye propozohet që t'i shqiptohet masë vërejtje publike TVM3 me afat të harmonizimit prej 20 ditësh dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli dhe në ndërkohë Sektori do të bisedojë me redaktorin e TVM3 dhe do t'i kërkohet të paraqesë të dhëna nga marrëveshjet për këto ndalesa të lajmëruara në deklaratë.

Lidhur me shkeljen e neni 92 paragrafi (1) të LSHMAAV nga NRP RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM4), udhëheqësja Janevska shpjegoi se shërbimi nuk ka transmetuar së paku 40% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, siç përcaktohet për shërbimin publik. Në ditën e analizuar është transmetuar 20,98% dhe për këtë arsye propozohet që TVM4 t'i shqiptohet masë vërejtje publike me afat harmonizimi prej 20 ditësh dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli. Ajo ka shpjeguar se TVM4 ka bërë deklaratë me shpjegim duke thënë se atë ditë kanë pasur problem teknik dhe për këtë ka ndodhur shkelja, por se tashmë kanë vepruar sipas masës së propozuar.

Z. Petrushevski tha se është e qartë se duhet të shqiptohet masë vërejtje publike dhe u pajtua se është mirë të bisedohet me TVM për të shmangur një situatë të tillë në të ardhmen dhe për të sqaruar keqkuptimet. Ai do të mbështesë edhe masën për TVM4, ku në deklaratë thonë se kanë pasur problem me kompjuterët dhe e pranojnë gabimin, ndërsa menjëherë kanë reaguuar dhe e korrigjuan.

Z. Ajdini tha se në deklaratën e TVM3 nuk kërkohet as falje apo se kanë bërë gabim, e dinë se kanë gabuar por nuk mund ta korrigjojnë. Për dallim nga deklarata e TVM4 ku pretendojnë se është për arsye teknike dhe gabim në llogaritje, e pranojnë gabimin dhe më pas kanë reaguuar. TVM3 kërkon që Agjencia të jetë fleksibile dhe pyeti nëse Agjencia ka një mundësi të tillë? Ai e din që javën e ardhshme do të ketë sërish ndeshje sportive dhe nëse vazhdojnë kështu sërish do të bëjnë shkelje që do të sjellë deri në shqiptimin e masës për kundërvajtje. Për sa i përket impresium, ai pyeti nëse ka mundësi që komentatori në fillim të ndeshjes me zë të tregojë të dhënat e nevojshme dhe në fund të ndeshjes gjithashtu?

Udhëheqësja Janevska tha se para së gjithash duhet të kontrollohen marrëveshjet e përmendura nga TVM3, cilat janë kufizimet, por edhe nëse ka kufizime, ajo nuk beson se ka kufizime për pjesët e studios. Edhe nëse ka kufizime gjatë kohës së ndeshjes, pjesa e studios është vetëm e produksionin të TVM-së. Ajo beson se këtu mund dhe duhet të publikohen të dhënat për impresium. Mirëpo, nëse ka kufizime në ndeshjet e tjera, nuk ka asnjë pengesë gjatë komentit të ndeshjes të tregon emrin e komentatorit dhe ekipit realizues të ndeshjes, ku publiku mund të marrë informacion minimal nëse nuk ka mundësi grafikisht të publikohet.

Z. Fidanoski tha se do t'i bashkohet diskutimit për TVM3 dhe ndoshta do të ndihmojë me fjalimin e tij. Ai do të japë mbështetje për shqiptimin e masës vërejtje publike të TVM3, por dëshiron të ndajë disa informacione që i ka si njohuri paraprake, të cilat do t'i ndihmojnë Shërbimit në rrjedhën e mëtutjeshme të kësaj teme. Pajtohet se duhet të shihen përgjigjet nga MRT3. Ajo që ai di është se TVM e ka të drejtën për një ndeshje në Ligën e Kampionëve dhe ajo është ndeshja derbi e çdo raundi që transmetohet të mërkurën dhe ajo ndeshje shkon në TVM1, TVM2 dhe TVM3 paralelisht, me të ftuarit në studio siç është shpjeguar. Ajo ndeshje nuk transmetohet të mërkurën në programet e kanaleve sportivertive që ritransmetohen nga operatorët në Maqedoni që kanë të drejta ekskluzive për Ligën e Kampionëve, përkatësisht ARENA Sport, vetëm qëndron me telop se transmetohet në TVM. Ai nuk e di se çfarë lloj kontrate është, por tha se ka ndjekur ndeshjet derbi të atij lloji dhe në televizione të tjera rajonale që kanë të drejta për vendet e tyre. Ai ka vënë re se transmetimi fillon më herët, se ka edhe bisedë në studio, dhe kalojnë direkt në fushë ku edhe nis nxemja (parapërgatitja), futen skuadrat e kështu me radhë. Ai nuk e di se në cilin moment TVM përfshihet në sinjalin e transmetimit televiziv, ndoshta edhe këtë duhet ta sqarojnë në mbledhje, duhet të dihet, sepse në pjesën paraprake ka një lloj njoftimi se kush do ta udhëheqë. Duke parë shërbimet e tjera që e transmetojnë apo e ritransmetojnë atë, ata verbalisht lajmërojnë kush janë komentatorët që mbase mund këtë ta bëjë edhe TVM, për të thënë se cilët janë komentuesit për atë ndeshje të caktuar. Ai supozon se ka mundësi ashtu siç ka mundësi në fund të pjesës së studimit për të treguar se kush e ka realizuar këtë program studimi. Sa i përket Ligës së Maqedonisë, ajo që di është se kanë bashkëpunim dhe koproduksion me ARENA Sport, e cila po ashtu ka të drejta për transmetim të ligës së futbollit maqedonas dhe ka vërejtur se edhe ndeshje të tjera transmetohen në ARENA Sport. Supozon se ajo paketë, ajo kontratë me ARENA Sport është e lidhur bashkërisht dhe me transmetimet nga Liga e Futbollit të Maqedonisë dhe Liga e Kampionëve, dhe ndoshta ka detaje që do të duhet TVM t'i shpjegojë për të konstatuar se çfarë lejohet dhe çfarë nuk lejohet. Ai deklaroi se do të mbështeste

shqiptimin e masës vërejtje publike dhe apelon që Shërbimi të realizon takim me personat përgjegjës në shërbimin publik, jo vetëm me TVM3, por edhe me TVM1 sepse ata transmetojnë të njëjtën ndeshje, dhe TVM2 që të mos ketë paqartësi në të ardhmen.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e rregullt administrative nr.10-3880/1 të datës 26.10.2023 dhe njëzëri konkludoi që NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (TVM3) t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkeljen e nenit 14 të Ligjit për Media sepse më 4 tetor 2023 në pjesë të programeve të transmetuara nuk i ka publikuar të dhënat që është i detyruar t'i transmetojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Në pajtim me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr. 01-4139/1 të datës 07.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-3910/1 datë 27.10.2023 dhe njëzëri konkludoi NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM4) t'i shqiptojë masën vërejtje publike për shkeljen e nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV sepse më 5 tetor 2023 nuk ka transmetuar së paku 40% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr.Emilija Janevska shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive SKAJ RADIO Teodor SHPKNJP - Shkup, për shkelje të nenit 80 paragrafët (7), (8) dhe (9) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se shkelja është konstatuar me mbikëqyrje të rregullt të kryer në shtator të këtij viti. Transmetuesi në ditën e analizës nuk ka transmetuar së paku 10% muzikë në gjuhën maqedonase në periudhën nga ora 06:00 deri në ora 00:00, nga totali i muzikës së transmetuar gjatë ditë-natës së analizës, siç ka raportuar vullnetarisht vitin e kaluar për vitin 2024. Prej aty, propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike me afat të harmonizimit prej 20 (njëzet) ditësh dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli. Nëse transmetuesi nuk vepron sipas masës së shqiptuar, do të duhet të paguajë shumën për të cilën në fillim të vitit i është ulur kompensimi për lejen.

Z. Fidanoski tha se nga Raporti shihet se për 24 orë është transmetuar 12,51% muzikë në gjuhën maqedonase, megjithatë në periudhën nga ora 06:00 deri në 00:00 nuk e plotëson kushtin prej 10%.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt programore, nr.10-3647/1 datë 04.10.2023 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive SKAJ RADIO Teodor SHPKNJP - Shkup, t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të neni 80 paragrafët (7), (8) dhe (9) të LSHMAAV dhe në lidhje me pikën 4 të Udhëzimit për paraqitjen vullnetare të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase, sepse më 4 shtator 2023 nuk ka transmetuar së paku 10% të muzikës në gjuhën maqedonase në periudhën nga ora 6 deri në orën 00, nga totali i muzikës së transmetuar në ditë-natën e analizuar.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me nenin 80 paragrafët (7), (8) dhe (9) të LSHMAAV dhe në lidhje me pikën 4 të Udhëzimit për paraqitjen vullnetare të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase.

Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektorit për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, e shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të

REPRO PRINT SHPKNJP nga Shkupi, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media. Ajo shpjegoi se më 26 tetor është bërë mnikëqyrje e rregullt në gjithsej 22 medime të shkruara për të përcaktuar nëse kanë publikuar impresium në pajtim me nenin 14 paragrafi (1) të Ligjit për media. Është konstatuar se tre botues të medias së shkruar nuk e kanë përmbushur detyrimin plotësisht. Njëri prej tyre është botuesi i gazetës së përditshme "Nova Makedonija", e cila në vend që të publikojë numrin e saktë të kopjeve të shtypura botoi "tirazh deri në 3500 kopje". Atyre u është kërkuar të deklarohen për shkeljen e konstatuar dhe kanë raportuar se në këtë mënyrë kanë konsideruar se nuk e kanë shkelur ligjin, por sapo kanë pranuar Raportin me shkrim të mbikëqyrjes nga Agjencia, tashmë janë korrigjuar dhe kanë publikuar numrin e kopjeve të shtypura gjatë ditës. Prandaj është propozuar që të shqiptohet masë vërejtje publike.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e rregullt administrative nr.03-3865/1 datë 26.10.2023 dhe njëzëri konstatoi që Shoqërisë për prodhim, qarkullim dhe shërbime REPRO PRINT SHPKNJP eksport-import Shkup, botues i "Nova Makedonija" t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media, sepse në botimin nr.25952 të datës 20.10.2023 nuk e ka përmbushur plotësisht obligimin nga neni 14 paragrafi (1) të Ligjit për media.

Në pajtim me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr. 01-4139/1 datë 07.11.2022, detyrohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e nenit 14 paragrafi (1) të Ligjit për Media.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për pagesë të ndihmës monetare - kompensim për vdekjen e anëtarit të familjes së ngushtë (babait), punonjësit të Agjencisë, në shumë prej 15.000,00 (pesëmbëdhjetë mijë) denarë.

Mjetet e lartpërmendura janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-4225/8

23.11.2023

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.